



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 19 - 2009

Prishtinë, më 01 qershor 2009, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Dzezair Murati, Ibrahim Makolli, Adem Hajdaraj dhe Selvije Halimi.

Munguan: Branislav Gërbiq dhe Dzezair Murati.

Të pranishëm: Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti - KDI, Reshit Gashi – NDI, Petrit Hysaj - OSBE, Almir Hyseni – EULEX dhe Gjyze Milla Loyla - University USA.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 25 majit 2009;
3. Shqyrtimi i Propozimplanit të Kuvendit për sfidat e Raportit të progresit të

- Komisionit Evropian për vitin 2008;
4. Shqyrtimi i kërkesës së Institutit Gjyqësor të Kosovës;
 5. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit lidhur me kërkesën e Grupit të Shoqërisë Civile për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për vetëqeverisje lokale;
 6. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Riza Smaka;
 7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari –Pasi i përshëndeti të pranishmit i falënderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit dhe i njoftoi të pranishmit për rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 15 majit 2009

Kryetari – I pyeti anëtarët nëse kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Propozimplanit të Kuvendit për sfidat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për vitin 2008;

Kryetari – Tha se keni njohuri për Raportin e progresit të Komisionit Evropian dhe për detyrat që dalin nga ky plan. Me stafin e Komisionit i kemi identifikuar dhe ndarë detyrat për Komisionin tonë, sepse në fillim kanë qenë të paqarta këtë çështje, por kemi arritur t'i qartësojmë edhe me Komisionin për Integritet Evropian dhe me komisionet e tjera. Ne e kemi përgatitur një raport dhe do ta përcjellim te Komisioni për Integritet Evropian dhe më pas do ta dërgojmë edhe në Kuvend. Nga Raporti shihet se duhet të merret nisma për nxjerrjen, ndryshimin ose plotësimin e ligjeve, p.sh.: ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Antikorrupsion dhe në kuadër të këtij plani dalin detyra për Ministrinë e Drejtësisë dhe për Qeverinë në tërësi.

Kryetari – I pyeti të pranishmit se a ka nevojë ta lexojë Rraportin e përgatitur nga Komisioni. Nëse nuk ka nevojë të lexohet, a ka dikush vërejtje lidhur me Raportin. Nga të pranishmit nuk pati vërejtje.

Armend Zemaj – Shtoi se sa i përket Raportit nuk kam vërejtje, por te pika 8 është pak diskutabile dhe komplekse çështja e sektorit të paluajtshmërive dhe Projektligji për konfiskimin e pronave. Këtë çështje e kemi diskutuar edhe atë ditë në debatin për privatizimin dhe kjo është një ndër problemet kryesore sa i përket rregullativës ligjore në Kosovë. Ne kemi miratuar Ligjin për shpronësimin, por ai i përket një fushe tjetër. Ndoshta këtu ka të bëjë me nacionalizimin e tokave, eksproprijimin e tokave pas shthurjes së Jugosllavisë. Kjo çështje ndoshta është më komplekse dhe nuk e di se çfarë kanë menduar ata në Raportin e progresit dhe si do t'i qasemi këtij problemi dhe çka do t'i rekomandojmë Qeverisë.

Kryetari – Vuri në pah se i kemi identifikuar detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Raporti për Komisionin tonë dhe obligohemi t’i rekomandojmë Qeverisë së Kosovës. Kemi të drejtë të kërkojmë nga Ministria e Drejtësisë të jetë më e efektshme.

Raporti u miratua njëzëri nga anëtarët e Komisionit.

4. Shqyrtimi i kërkesës së Institutit Gjyqësor të Kosovës;

Kryetari – Theksoi se Instituti Gjyqësor i Kosovës na ka njoftuar lidhur me skadimin e mandatit të një numri të anëtarëve të Këshillit Drejtues të IGJK-së, që nga data 4 qershor. Mendon se institucionet përkatëse duhet të njoftohen nga IGJK-ja për skadimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues, në mënyrë që të veprohet konform Ligjit për themelimin e IGJK-së.

Ibrahim Makolli – Tha se nëse u skadon mandati më 4 qershor, pra të enjten, ky institucion do të jetë pa funksion. Kështu na ka ndodhur edhe me trupa të tjerë. Ky institucion do të jetë pa Këshillin Drejtues. Kështu ka ndodhur edhe me Këshillin Gjyqësor. A ka ndonjë periudhë pas së cilës ligji i detyron të na njoftojnë më parë, e jo 3 - 4 ditë para skadimit të mandatit. A mundet dikush t’ua tërheqë vërejtjen për këto çështje?

Adem Salihaj - Në diskutimin e tij shtoi se tashmë është bërë dukuri që agjencitë e themeluara nga Kuvendi nuk ndërmarrin asgjë, ndonëse u ka skaduar mandati. Është mirë që shërbimi i administratës të shikojë dhe të përcjellë mandatin e këtyre agjencive dhe t’i raportojë Komisionit, në mënyrë që të shihet se ku është përgjegjësia. Në këtë rast e kishte fjalën për IGJK-në. Theksoi se duhet të ndërpritet kjo praktikë që institucionet të mbesin me mandat të skaduar.

Bajram Kosumi –Shtoi se kjo që po diskutojmë është një njoftim nga IGJK-ja. Nuk jemi të detyruar për asgjë, sepse vetëm na ka njoftuar. Çështja më thelbësore është krijimi i një ure lidhëse ndërmjet Komisionit e Kryesisë së Kuvendit dhe Komisionit dhe Qeverisë. Ndonëse se kjo urë ekziston. IGJK-së i kalon mandati dhe mendon se duhet ta njoftojnë Kryesinë e Kuvendit, që të kërkojë nga Qeveria, e pastaj ajo të kërkojë nga institucionet që t’i nominojnë anëtarët e vet në këtë këshill drejtues të IGJK-së.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës Komisioni nxori këtë

Përfundim

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi t’ia bëjë një shkresë IGJK-së, që ta fillojë procedurën e nominimit për anëtar të Këshillit Drejtues të IGJK-së.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi t’ia bëjë një shkresë Shoqatës së Prokurorëve të Kosovës, që të dërgojë një anëtar të një komuniteti joshqiptar në Këshillin Drejtues të IGJK-së.

5. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit lidhur me kërkesën e shoqërisë civile për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për vetëqeverisje lokale

Kryetari – I njoftoi të pranishmit për përfundimin e Kryesisë së Kuvendit lidhur me shqyrtimin e kërkesës së Grupit të Shoqërisë Civile për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-040 për vetëqeverisjen lokale dhe shtoi se ky përfundim u është drejtuar tri komisioneve të Kuvendit: Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione dhe Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës anëtarët e Komisionit ishin të mendimit që të diskutohet në njërin nga mbledhjet e ardhshme.

6. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Riza Smaka;

Komisioni shqyrtoi edhe kërkesën e deputetit Riza Smaka, që kishte të bënte me përzgjedhjen e gjyqëtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, që edhe ishte kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Komisioni nxori këtë

përfundim

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi nuk ka autoritet t'i shqyrtojë vendimet e Kuvendit të Kosovës.

Procesverbali u hartua nga Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni